

VENDIM
Nr. 115, datë 21.4.2026

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 262, DATË 21.10.2025 ‘MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘VIVID POWER’ SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE’, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 41/4 prot., datë 17.4.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 262, datë 21.10.2025 ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Vivid Power’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike’”, i ndryshuar”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Vivid Power” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 262, datë 21.10.2025, i ndryshuar me vendimin nr. 11, datë 15.1.2026, ka licencuar shoqërinë “Vivid Power” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

- Në pikën 2 të këtij vendimi është përcaktuar, se: “Me fillimin e operimit, shoqëria të depozitojë në ERE informacionin e përditësuar në lidhje me sistemin IT dhe strukturën organizative me stafin teknik efektiv për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike”, ndërsa në pikën 4 është përcaktuar, se: Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendimmarrje me shkresën nr. 41/2 prot., datë 22.1.2026, duke i sjellë në vëmendje edhe detyrimin për plotësimin e kushtit.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 41/3 prot., datë 7.4.2026, shoqëria ka depozituar në ERE marrëveshjen e shërbimit për ofrimin e shërbimeve IT dhe stafit teknik-administrativ.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 3 të vendimit nr. 262/2025 dhe me plotësimin e këtij kushti rezulton se nuk gjen më zbatim sa përcaktuar në pikën 4 të vendimit, ndaj vlerësohet edhe shfuqizimi i kësaj pike.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet nga organi kompetent.

- Duke qenë se është përmbushur kushti i përcaktuar në pikën 2 të vendimit nr. 262/2025, të ndryshuar, vlerësohet se kjo pikë duhet të shfuqizohet, si dhe pika 4 e këtij vendimi, e cila nuk gjen më zbatim, duhet, gjithashtu, të shfuqizohet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 262, datë 21.10.2025, i ndryshuar, si vijon:

a) Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 262, datë 21.10.2025, i ndryshuar, shfuqizohet.

b) Pika 4 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 262, datë 21.10.2025, i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Vivid Power” sh.p.k., “Operatorin e Sistemit të Transmetimit” sh.a. dhe “Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti